



Nr. Prot.: 198  
Datë: 27 / 1 / 2023

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 28, paragrafi 1.6 të Statutit të UP-së dhe nenin 6 të Rregullores nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të punës së Senatit të UP-së, thërret mbledhjen e 39-të të rregullt të Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me këtë:

### REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së 38-të të Senatit të UP-së, mbajtur me datë 29.12.2022.
2. Shqyrtim dhe marrje e vendimit për konfirmimin e vendimeve të Këshillit të Etikës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të KQSD-së për lejimin e temave të doktoratës dhe të mentorëve, sipas raportit të KQSD-së;
4. Shqyrtimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës, sipas raportit të KQSD-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Etikën në Kërkime Shkencore;
6. Marrja e vendimit për formimin e komisionit për plotësim – ndryshim të Rregullores për Studimet e Doktoratës në UP;
7. Shqyrtimi dhe vendosja lidhur me raportet me nr. prot. 4/593, datë 28.12.2022 dhe nr. prot. 4/593, datë 28.12.2022 të Komisionit për ankesa dhe parashtresa të Senatit;
8. Delegimi i dy përfaqësuesve (anëtarë të Senatit nga radhët e personelit akademik) në grupin punues për rishikimin, plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
9. Miratimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore për zgjedhjen e prodekanëve: 1. Prof. dr. Arben Haziri - prodekan për çështje mësimore dhe 2. Prof. asoc. dr. Ferim Gashi - prodekan për cilësi dhe shkencë;
10. Miratimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit të Arkitekturës për zgjedhjen e prodekanëve: 1. Prof. ass. dr. Arta Xhambazi – prodekan për infrastrukturë financa, si dhe 2. Prof. asoc. dr. Teuta Jashari Kajtazi - prodekan për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar;
11. Miratimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë për zgjedhjen e Prof. ass. dr. Zana Sllamniku Dalipi, në cilësinë e prodekanes për financa dhe infrastrukturë;
12. Miratimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit Filozofik për zgjedhjen e Dr. Dorajet Imeri, në cilësi të u.d. të prodekanit për mësim dhe çështje të studentëve të Fakultetit Filozofik;
13. Shqyrtimi i dy kandidatëve për shpalljen në titullin *Doctor Honoris Causa*;
14. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me propozimin e Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, për caktim të titullit "Profesor Emeritus" për Prof. dr. Sadi Bexhetit;
15. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me propozimin e Këshillit të Fakultetit të Arteve, për caktim të titullit "Profesor Emeritus" për Prof. Enver Petrovcin;

16. Diskutim lidhur me vlerësimin e vazhdueshëm të studentëve në UP;
17. Të ndryshme.

**Mbledhja do të mbahet ditën e hënë, me datë 30.1.2023, me fillim prej orës 11:00.**

